



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

URDHËR

Nr 157, datë 12.2.2018

MBI

“KRIJIMIN E TRE SHOQËRIVE TË KONTROLLUARA NGA OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Nenit 72 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Statutit të Shoqërisë së Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A, Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “OSHEE” SH.A Nr. 65 datë 19.12.2016 dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme Nr. 458 datë 15.02.2017 “Për aprovimin e modelit të Korporatës”,

URDHËROJ:

1. Krijimin nga shoqëria “OSHEE” SH.A (shoqëria mëmë), nw pwrputhje me nenin 207 tw ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të tre shoqërive të kontrolluara, me qëllim ndarjen e aktivitetit të shpërndarjes, shërbimit universal të furnizimit dhe aktivitetit të shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike, si më poshtë:
 - a) Shoqëria e Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL SH.A), me objekt veprimtarie blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë etj;
 - b) Shoqëria e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU SH.A), me objekt veprimtarie furnizimin me energji të klientëve të rregulluar si dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit etj;
 - c) Shoqëria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH SH.A), me objekt veprimtarie shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj.
2. Shoqëria “OSHEE” SH.A (shoqëria mëmë), të ketë pjesëmarrje 100% në të treja shoqëritë e kontrolluara të përcaktuara në pikën 1 të këtij Urdhri.

3. Shoqëria "OSHEE" SH.A do të zotërojë 100% të aksioneve të shoqërive FTL SH.A, FSHU SH.A dhe OSSH SH.A. Forma juridike e shoqërive të reja që do të krijohen të jetë shoqëri aksionere, me ofertë private. Kapitali themeltar për krijimin e shoqërive FTL SH.A, FSHU SH.A dhe OSSH SH.A do të jetë 3.500.000 (tre milion e pesëqindmijë) Lek për çdo shoqëri. Kapitali themeltar i secilës shoqëri është i ndarë në 3,500 (tre mijë e pesëqind) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) Lek, secila.
4. Shoqëria "OSHEE" SH.A, në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërive të kontrolluara, autorizohet të ndjekë procedurat ligjore për ndarjen e asetëve fikse dhe të llogarive financiare për shoqëritë që do të krijohen sipas këtij urdhëri, në përputhje me objektet e veprimtarisë së tyre dhe pasqyrat financiare të vitit 2017 të miratuara të shoqërisë "OSHEE" SH.A, dhe me parashikimet e Nenit 72 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".
5. Afati për përfundimin e procesit të ndarjes së shoqërive është brenda datës 31.12.2018.
6. Shoqëritë e kontrolluara do të jenë shoqëri me një nivel administrimi. Funkcionet e përfaqësuesit të aksionerit të OSHEE Sh.A. në shoqëritë e kontrolluara, i ushtron Administratori i OSHEE Sh.A.
7. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë "OSHEE" SH.A të përfundojë brenda afateve ligjore regjistrimin e shoqërive tregtare FTL SH.A, FSHU SH.A dhe OSSH SH.A në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për zbatimin e Nenit 72 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Damian Gjikhuri

